



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 820/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Kimete Gashi - Kryetare, Vedat Poterqoi Antar, dhe Agon Ramadani Antar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "Company Murseli", sh.p.k me seli në Kaçanik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi si dhe pastrimi, bartja e mbetjeve inerte dhe materialeve tjera" me nr. i prokurimit : 616-22-12172-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës, me datë 24.03.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Hedhet poshtë si e palejuar** ankesa e operatorit ekonomik, "Company Murseli", sh.p.k me seli në Kaçanik, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me numër protokolli 820/2022 me datën 31.12.2022, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi si dhe pastrimi, bartja e mbetjeve inerte dhe materialeve tjera" me nr. i prokurimit : 616-22-12172-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës.

**II. Vazhdohet me** aktivitetin e prokurimit me titull: "Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi si dhe pastrimi, bartja e mbetjeve inerte dhe materialeve tjera" me nr. i prokurimit : 616-22-12172-5-2-1, iniciuar nga Komuna e Prishtinës.

**III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim** Panelin Shqyrtues të OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuara me numër dhe datë si në paragrafët paraprak të dispozitivit të këtij vendimi.

IV. Meqenëse ankesa e OE “Company Murseli”, sh.p.k me seli në Kaqanik, hedhet si e palejuar, i behët kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **A r s y e t i m**

#### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Komuna e Prishtinës në cilësinë e autoritetit kontraktues me datën 18.10.2022, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Rrënimi i objekteve pa leje ndërtimi si dhe pastrimi, bartja e mbetjeve inerte dhe materialeve tjera” me nr. i prokurimit : 616-22-12172-5-2-1. Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 100 000.00 €.

Me datë 21.12.2022, OE ankues “Company Murseli”, sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rivlerësim në AK, Komuna e Prishtinës, me datë 22.12.2022, AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

I pakënaqur me vendimin e AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim, OE ankues “Company Murseli” me datën 31.12.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër protokolli 820/22.

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

#### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

OSHP ka angazhuar ekspertin e jashtme shqyrtuese të prokurimit që në pajtim me nenin 113 të LPP-së, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore i cili në raportin e datës 13.01.2023 ka rekomanduar që:

- Të anulohet në mungesë të ofertave të përgjegjshme aktiviteti i prokurimit të sipër shënuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor një l vlerëson që ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar pasi që në dosje të tenderit dhe në njoftim për kontratë vlera e parashikuar për këtë projekt ishte 100,000.00 €, ndërsa oferta financiare e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është 203,640.00 €, pra kishte tejkalimi të buxhetit më shumë se dyfishi pra AK pas hapjes se ofertave është dashur të anulojë procedurën e prokurimit, pasi që vlera e ofertës ka tejkaluar në mënyrë substanciale vlerën e parashikuar nga AK. (Neni 63 i LPP-së, ku pikën 2 theksohet se Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet: 2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit).

Sa i për këtë pretendimit tjetër të OE ankues paneli shqyrtues sqaron se AK i ka paraqitur si dëshmi Licencë për administrimin e mbeturinave me nr.0072/16 e lëshuar nga MMPH, për NTSH “Krasniqi”, e cila ka skaduar qysh më 09.10.2021, pra OE ankues e ka neglizhuar kërkesën e AK dhe në këtë rast AK Komuna e Prishtinës, ka vepruar drejt, pasi që licenc për administrimin e mbeturinave me nr.0072/16 e lëshuar nga MMPH, për NTSH “Krasniqi”, ishte e skaduar qysh më 09.10.2021, po ashtu AK ka kërkuar që me dokumentet ofertuese edhe Sigurim Tenderi në vlerë 2,000.00 euro, i vlefshëm për 150 ditë. Sigurimi i Tenderit do të thotë siguri (garantim) për tender (Neni 57, i LPP-së). Sigurimi i tenderit është paraparë si mbulesë që: a) Tenderuesi ka ofruar informata të vërteta; b) Tenderi është valid për periudhën e kërkuar të validitetit; c) Tenderuesi respekton kushtet para nënshkrimit të kontratës, përfshirë depozitimin e sigurimit të ekzekutimit; dhe d) Tenderuesi përmbyllë kontratën.

Pra OE ankues nuk e ka vepruar në harmoni me pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional dhe IV.3) Informacionet Administrative, të njoftimit për kontratë dhe si rrjedhojë këtë pretendim të OE ankues “Muresli Compani” sh.p.k paneli e vlerëson si të pa qëndrueshëm,

Pretendimi tjetër OE ankues është pjesërisht i bazuar, pasi që është që i mbetet në përgjegjësin e AK që të argumentoj, se mbi çfarë kriteri të përdorur është aplikuar kjo kërkesë dhe se ku qëndron dallimi i punëve të kryera nga e njëjta makineri për të njëjtin projekt mirëpo kërkohet oferta duke u bazuar në 2 parametra matës të ndryshëm, në rastin e parë m3 dhe në të dytën orë pune.

Pretendimin e fundit të OE ankues paneli shqyrtues e vlerëson si pjesërisht të bazuar dhe ka bazë për ngritjen e dyshimeve se çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar në të gjitha pikat ankimore, vërehet se ka bazë që të njëjtat të jenë jo-normalisht të ulëta dhe se mbetet në përgjegjësin e AK që të njëjtat ti argumentoj ndryshe, duke shfrytëzuar të drejtën ligjore sipas LPP-së Neni 61, paragrafi 1 dhe 2.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues vlerëson se AK duhet që në këtë aktivitetit të prokurimit, duhet që të marrë parasysh të gjitha gjetjet e ekspertit shqyrtues që nga inicimi i kësaj procedure e deri të nënshkrimi i kontratës.

Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast. Lidhur me këtë, duhet theksuar se në paragrafin 1.26, të nenit 4 (Përkufizimet), të LPP, përkufizohet shprehimisht statusi i palës së interesuar, sipas të cilit palë e interesuar është personi që mund të *dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit*, i zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshirë cilindo person i cili ka qenë ose *mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar*. Paragrafi i cituar, do të thotë se Ankuesi duhet të *dëshmojë interes material*, thënë me saktë interesin e tij material dhe të dëshmojë njëherësh faktin, nëse është *dëmtuar nga një shkelje e pretenduar*. Nga pikëpamja e këtij Paneli, kjo nuk bje nën juridiksionin e institutit të ankesës prandaj ankesës në rastin konkret i mungon qëllimi i sajë, siç parashikohet me LPP. Në kontekstin shpjegimeve si më sipër, Paneli i vuri në zbatim për hirë të së vërtetës materiale dhe gjykimit objektiv në këtë rast edhe dispozitat si në vijim:

- Në nenin 103, të LPP, thuhet: “Dispozitat e kësaj pjese përcaktojnë të drejtat themelore dhe procedurale dhe mjetet juridike në *dispozicion të palëve të interesuara* siç është përkufizuar ky term (“palë e interesuar”) në nenin 4 të këtij ligji”. Kuptimi i kësaj dispozite vërteton fare qartë mendimin e këtij Paneli se, mjetet juridike mund të vihen në lëvizje vetëm nga *palët e interesuara* duke ju referuar në këtë rast pikërisht përkufizimit të dhënë në nenin 4, të LPP.

- Po ashtu, në nenin 111, të LPP parashihet se çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë, kurse OSHP do të marrë masa nëse ankesa e tillë vërteton se parashtruesi kualifikohet si *palë e interesuar siç është përkufizuar kjo shprehje në nenin 4 të këtij ligji*” (shih: paragrafi 1.5). dhe se “...shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t’i shkaktojë *dëme materiale parashtruesit të ankesës..*” (shih paragrafi 1.8.).

Prandaj bazuar në kuptimin e nenit 4, të LPP, lidhur me nenin 103 dhe 111, të këtij Ligji, Paneli konsideron se ankesa në rastin konkret a) nuk i plotëson elementet qenësore dhe qëllimin e sajë (së paku në kuptim të paragrafi 1, lidhur me nën-paragrafin 1.5). Kurse b) parashtruesi i saj nuk mund të konsiderohet palë e interesuar. Prandaj për shkaqet dhe arsyet e cituara si më sipër, paneli vlerëson se pretendimet e kësaj Ankese, janë jo lëndore në kuptim të neni 111, të LPP. Krahas dispozitave të cituara si më sipër, po ashtu edhe me nenin 124 (Legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative) paragrafi 1, të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative (Ligji Nr. 05/L -031), thuhet qartë se, cituar: “Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim”.

- Përfundim –

Bazuar në kompetencat e OSHP të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP, Paneli Shqyrtues vuri në zbatim mes tjerash dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të cilit të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Kimete Gashi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet

Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Prishtinës

1x1 OE "Company Murseli", me seli në Kaqanik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.